



Pranuar / Dorezuar Priljena / Prodato Received / Delivory	27.09.2022	2	viti god. year
Organ / Mjesta Org / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shitjca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDM8/HCK	5704/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.610/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi -anëtare si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1640/21, të datës 30.06.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr 610/2021 të datës 05.07.2021 të parashtruar nga ankuesi

Prishtinë, kundër heshtjes administrative të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 27.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Detyrohet Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e datës 31.05.2021 me nr. protokolli 745 të parashtruar nga ankuesi
- II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 05.07.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3449/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër heshtjes administrative sipas kërkesës së datës 31.05.2021 drejtuar Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.07.2021 ka dërguar kërkesën për

përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Më datë 16.07.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme me shkresat e bashkangjitura të lëndës 1/7.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.08.2021 përmes Njoftimit me numër protokollit 4311/2021, ka njoftuar ankuesin se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.nr.610/2021 të datës 05.07.2021, për shkak se Këshilli nuk ishte funksional, duke e udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative me datë 30.06.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1640/21 i pranuar në KPMSCHK më datë 02.09.2022, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke anuluar njoftimin e datës 07/07/2021, ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet se gjykata gabimisht i është adresuar njoftimit të kësaj date pasi njoftimi i anuluar është i datës 23.08.2021 i KPMSHCK-së me që rast ka obliguar Këshillin që të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.610/2021 të datës 05.07.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokollit 3449/2021 të datës 05.07.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.1640/21 i datës 30.06.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative i pranuar në KPMSCHK më datë 02.09.2022; Kërkesë e përfaqësuesit të ankuesit Avokatit me numër protokollit 5167/2022 e datës 06.09.2022; Flet kthesë e datës 02.09.2021; Njoftim me numër protokollit 4311/2021 i datës 23.08.2021; Pliko me nr. R1802707 i datës 24.08.2021; Kërkesë me nr. protokollit 745 e datës 31.05.2021; E-mail nga B.H. për T.M. i datës 25.06.2021; E-mail nga B.H. për T.M. i datës 09.06.2021; E-mail nga B.H. për T.M. i datës 31.05.2021; E-mail zyrtar i datës 24.05.2021 për B.H.; Vendim për caktimin e zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të ARC-së me nr.0194/2021 i datës 24.05.2021; Vendim me nr. 614/2020 i datës 06.05.2020; Vendim me nr.14/144 i datës 04.05.2017; Vendim me nr.42/2017 i datës 16.02.2017; Ndryshim i Aktit të Emërimit i B.H. me nr.781 i datës 02.12.2013; Vendim i datës 21.11.2012; Vendim për ricaktimin në vendin e ri të punës të datës 22.02.2007; Vazhdim i Emërimit i i datës 05.01.2004; Certifikatë e B.H. e datës 27.09.2016; Certifikatë e e datës 27.03.2007; Certifikatë nga Diesecke Devrient për B.H. e datës 11.07.2013; Certifikatë nga Diesecke Devrient për B.H. e datës 11.06.2013; Certifikatë e B.H. e muajit Prill 2014; Certifikatë nga Datacard Group për B.H. e muajit shtator 2011; Certifikatë nga General Management për B.H. e muajit Janar 2005; Certifikatë nga Ministria e Shërbimeve Publike Departamenti i Teknologjisë Informative për B.H. i datës 01.06.2005; Certifikatë nga CRPK/UNHCR për B.H.; Certifikatë nga MPB për B.H. i datës 22.11.2016; Certifikatë nga United Nations Interim Administration Mission in Kosovo për B.H. i datës 11.06.2001; Certifikatë nga OSCE për B.H. i datës 12.05.2003; Fletë kthesë e datës 13.07.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 12.07.2021; Përgjigje në ankesë e datës 16.07.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore që të detyrohet organi administrativ kompetent konkretisht Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, që të nxjerrë akt administrativ, lidhur me kërkesën e datës 31.05.2021 me numër protokollit 745, të parashtruar nga ankuesi *sepse*

Bazuar në provat e lëndës konkretisht Ndryshimit të Aktit të Emërimit me nr. protokoll 781 të datës 02.12.2013 është konstatuar se ankuesi ka qenë i punësuar në vendin e punës "Udhëheqës i Divizionit të Prodhimit" Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve Agjencia e Regjistrimit Civil MPB, pas procedurave të rekrutimit zgjidhet në pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Prodhimin e Dokumenteve, Agjencia e Regjistrimit Civil MPB me nr. ref. DPD-1/2013 duke filluar nga data 02.12.2013, ndërsa përmes vendimit të datës 16.02.2017 me Nr.42/2017 është caktuar si ushtrues i detyrës në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Regjistrim Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i njëjti përmes vendimit të datës 04.05.2017 me Nr.14/144 është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil të Ministrisë së Punëve të Brendshme me mandat tre (3) vjeçar. I njëjti më datë 06.05.2020 me Nr.614/2020 është caktuar Ushtrues i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil. Ndërsa përmes vendimit të datës 24.05.2021 me Nr.0194/2021 është nxjerr vendimi nga Ministri i Punëve të Brendshme, ku është caktuar z. B.C Drejtor i Drejtoratit të Gjendjes Civile zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Regjistrimit Civil ku sipas pikës tre (3) të këtij vendimi është shfuqizuar vendimi me Nr. 614/2020 i datës 06.05.2020 përmes së cilit vendim këtë pozitë e kishte ushtruar ankuesi deri më këtë datë.

Ankuesi me datë 31.05.2021 me nr. protokoll 745 përmes shkresës zyrtare/aktit administrativ i është drejtuar Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për ta sistemuar në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese përkatësisht në pozitën e "Drejtorit të Departamentit të Prodhimit të Dokumenteve" ndërsa i njëjti nuk ka marrë përgjigje lidhur me kërkesën e tij. Përsëri ankuesi përmes e-mailave të datës 31/05/2021,09/06/2021 dhe 25.06.2021, e ka përsëritur kërkesën tek Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe tek ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme me qëllim që të marrë një përgjigje në lidhje me kërkesën e datës 31.05.2021 për ta sistemuar në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese përkatësisht në pozitën e "Drejtorit të Departamentit të Prodhimit të Dokumenteve" dhe përsëri nuk ka marrë përgjigje lidhur me kërkesën e tij.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka parashtruar ankesë kundër heshtjes administrative sipas kërkesës së datës 31.05.2021 me nr. protokoll 745 drejtuar Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa kolegji i keshillit konstaton se ankesa është e bazuar nga se është në harmoni me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031, i cili parasheh "*Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ*" dhe në këtë kuptim është e domosdoshme që organi kompetentë në këtë rast DMZP-ja të veproj konformë përgjegjësive ligjore që i takojnë sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ashtu që të shqyrtojë hollësisht kërkesën e datës 31.05.2021 dhe të nxjerrë vendim meritore bazuar në dispozitat e Legjislacionit të Shërbimit Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi me datë 31.05.2021 me nr. protokoll 745 ka parashtruar kërkesë tek Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, nga i cili ka kërkuar që t'i ndërmerr veprimet ligjore për ta sistemuar në njëtin në pozitë të kategorisë së mesme drejtuese përkatësisht në pozitën e "Drejtorit të Departamentit të Prodhimit të Dokumenteve" në kuadër

të Ministrisë e Punëve të Brendshme. Mirëpo sipas shkresave të lëndës Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, nuk ka nxjerr një akt administrativ lidhur me çështjen përkatëse respektivisht kërkesën e datës 31.05.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi, ka analizuar dispozitat e nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6, nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.16 dhe nenin 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik si njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, është kompetent për të nxjerrë akt administrativë në lidhje me kërkesat e kësaj natyre.

Andaj, duke marrë parasysh rrethanat si më lartë, Kolegji konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, është i obliguar që të shqyrtoj kërkesën e datës 31.05.2021 me numër protokolli 745 të parashtruar nga ankuesi si dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat e Legjislacionit të Shërbimit Civil që ndërlidhen me rastin konkretë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.610/2021, datë 27/09/2022.

Çlirim Zeka

Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

